

VENDIM
Nr. 83/2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
93/2017, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.12.2020

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(36)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE		(16)
DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	2

Përkthyes	II-b	5
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE		(10)
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	1
Specialist protokoll/arkivi ****	IV-a	2
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	2
Shofer/korrier	VI	1
Total		76

Shënim:

**Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

***Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

****** Përfutimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

